VENDIM
Nr. 166, datë 18.3.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

(ndryshuar me vendimin nr. 776, datë 12.12.2022; nr. 691, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, në masën 996 684 324 (nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", Njësia Administrative Babrru, Bashkia Kamzë, në masën 501 596 868 (pesëqind e një milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë;

b) Për rindërtimin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit", Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamzë, në masën 286 531 800 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind) lekë;

c) Për rikonstruksionin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e gjimnazit "Gramoz Palushi", Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamzë, në masën 208 555 656 (dyqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 199 336 865 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit (zbatimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit) të objekteve arsimore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/1. Përveç përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, në masën 110 000 000 (njëqind e dhjetë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 553 165 340 (pesëqind e pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit (zbatimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit), *sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2* të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama